



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 1552 Prot.

Tiranë, 30.4 2020

Lënda: Mbi veprimet e paligjshme, me pasoja për Universitetin e Tiranës, të ish anëtarëve të KIZ të UT

Drejtuar: Personelit akademik të Universitetit të Tiranës

Së pari ju uroj shëndet në këtë kohë të vështirë pandemie që po kalojmë, të shkakton nga virusi Covid 19, juve dhe të gjithë familjarëve tuaj.

Jam njohur në rrugë jozyrtare me disa dokumenta të firmosura nga ish anëtarët e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve të UT, me të cilat, mund të jenë njohur edhe shumë prej jush.

Në lidhje me këto dokumenta, ju sqaroj se:

Së pari, ish anëtarët e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve të UT, janë zgjedhur në këtë detyrë nga Senati Akademik me Vendimin nr.8 datë 21.03.2016 të Senatit Akademik të UT, në zbatim të nenit 6, pika 1, gërma a të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të parapër autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në RSIP", me nr.2459/4 prot, datë 15.03.2016 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, tashmë të shfuqizuar.

Së dyti, në zbatim të nenit 26 të Rregullores së sipërcituar, në të cilën theksohet se **mandati i anëtarëve të KIZ, është 4 (katër) vjeçar**, ish anëtarëve të KIZ i ka përfunduar mandati dhe tashmë, ata janë vetëm ish anëtarë të një prej komisioneve të shumta institucionale zgjedhore që ka patur në gjithë këto vite në Universitetin e Tiranës.

Së treti, sikurse duhet ta dini, në Universitetin e Tiranës, me Vendimin nr.5 datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT, është miratuar Rregullorja "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës" dhe sigurisht, të gjitha procedurat që do të ndiqen për realizimin e një procesi zgjedhor të ligjshëm për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese dhe anëtarëve të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, do të bazohen dhe do të mbështeten vetëm tek kjo Rregullore e Zgjedhjeve, në ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe në aktet e tjera në fuqi në lidhje me këtë proces kaq të rëndësishëm për institucionin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Në këto kushte, të gjitha dokumentat e firmosura nga ish anëtarët e KIZ janë nul, të paligjshme, pa asnjë vlerë ligjore, dhe për më tepër, me qëllime të dukshme dhe të qarta tashmë nga të gjithë, për të penguar zhvillimin e një procesi zgjedhor të ligjshëm dhe për të zgjedhur ato autoritete drejtuese dhe anëtarë të Senatit Akademik të UT, që vërtet e meritojnë.

Për sa më sipër, do të kërkoja nga ana juaj të jeni të kujdesshëm në lidhje me këto dokumenta, të nisura nga persona të pa autorizuar nga ligji dhe autoritetet dhe organet drejtuese të UT, dhe me të gjithë procesin zgjedhor në përgjithësi që do të zhvillohet së shpejti në Universitetin e Tiranës.

Gjithashtu, do të kërkoja nga ana juaj të konsultoheni me Rregulloren "*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe Senatit Akademik në Universitetin e Tiranës*" tashmë të miratuar, dhe të shpallur në adresën zyrtare të Universitetit të Tiranës www.unitir.edu.al.

Shumë shpejt, do tju përcillen nga kjo adresë dokumenta dhe shkresa zyrtare që kanë lidhje me procesin zgjedhor të ligjshëm që do të zhvillohet në Universitetin e Tiranës.

Duke ju falenderuar, shpreh besimin në mirëkuptimin tuaj.

REKTORI
PROF. DR. AI NYR KONI